

ZRRUM – R 03 / SWC

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA (“ZRRUM”)

---

**RREGULL**  
**PËR STANDARDET E SHËRBIMIT**  
**PËR**  
**OFRUESIT E SHËRBIMEVE PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE**  
**NË KOSOVË**

26 – Janar – 2005

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>TABELA E PËRMBAJTJES .....</b>	<b>2</b>
<b>PJESA 1: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....</b>	<b>5</b>
Kapitulli 1 Fushëveprimi, Qëllimi dhe Definicionet .....	5
Neni 1 : Autoriteti për këtë Rregull .....	5
Neni 2 : Fushëveprimi .....	5
Neni 3 : Qëllimi.....	5
Neni 4 : Definicionet.....	5
Neni 5 : Rregullat e Interpretimit.....	9
<b>PJESA 2: PARIMET E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>9</b>
Kapitulli 1 Aplikueshmëria .....	9
Neni 6 : Aplikueshmëria .....	9
Kapitulli 2 Parimet e Përgjithshme për Standardet e Shërbimeve .....	9
Neni 7 : Zbatimi i Përgjithshëm i Punës .....	9
Neni 8 : Standardet e Shërbimit Kuantitativisht të Definuar.....	9
Neni 9 : Ofrimi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.....	10
Neni 10 : Obligimi për të Ofruar ose për të Mos Ofruar Shërbimet .....	10
Neni 11 : Mos Diskriminimi .....	11
<b>PJESA 3: PROCEDURAT .....</b>	<b>12</b>
Kapitulli 1 Pajtueshmëria dhe Lirimi.....	12
Neni 12 : Pajtueshmëria më Standardet e Shërbimit.....	12
Neni 13 : Lirimi nga Standardet e Shërbimit .....	12
Kapitulli 2 Rishikimi i Standardeve të Shërbimit .....	12
Neni 14 : E Drejta e Rregullatorit për Rishikim, Ndryshim, Plotësim ose Zëvendësim të Standardeve të Shërbimit.....	12
Neni 15 : Rishikimi i Standardeve të Shërbimit nga ana e Rregullatorit.....	13
Neni 16 : Njoftimi .....	13
<b>PJESA 4: MARRËVESHJA PËR STANDARDET E SHËRBIMIT .....</b>	<b>14</b>
Kapitulli 1 Arsyet për Negociata dhe Lidhja e Marrëveshjes për Standardet e Shërbimit .....	14
Neni 17 : Arsyet për të Lidhë Marrëveshjen për Standardet e Shërbimit .....	14
Neni 18 : Negocimi i një Marrëveshjeje për Standardet e Shërbimit .....	14
Neni 19 : Lidhja e Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimit .....	15
Kapitulli 2 Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimit .....	16
Neni 20 : Natyra Ligjore .....	16
Neni 21 : Pajtueshmëria me Marrëveshjen e Standardeve të Shërbimit .....	16
<b>PJESA 5: STANDARDET E SHËRBIMIT .....</b>	<b>16</b>
Kapitulli 1 Orari i Punës dhe Qasja e Konsumatorëve .....	16
Neni 22 : Zyra e Punës dhe Orari i Punës .....	16
Neni 23 : Identifikimi i Ofruesit të Shërbimeve .....	17
Kapitulli 2 Nën-Kontraktuesit.....	17
Neni 24 : Shfrytëzimi i Nën-Kontraktuesve.....	17
Kapitulli 3 Ndërprerja e Shërbimeve për Shkak të Force Majeure.....	18
Neni 25 : Rrethanat e Përgjithshme të Force Majeure .....	18
Neni 26 : Faktorët Klimatik .....	18

Neni 27 : Mbyllja e Rrugëve për Kalim.....	18
Neni 28 : Zonat e Pasigurta.....	19
Kapitulli 4 Ndërprerjet e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për Shkaqe që janë brenda Kontrollit të Ofruesit të Shërbimeve.....	19
Neni 29 : Të Përgjithshme.....	19
Neni 30 : Automjetet për Grumbullimin e Mbeturinave Jashtë Përdorimit..	19
Neni 31 : Shqetësimet, Akcionet dhe Grevat e Punëtorëve .....	19
Kapitulli 5 Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave.....	20
Neni 32 : Pajisjet për Grumbullimin e Mbeturinave.....	20
Neni 33 : Ekzaminimi i Mbeturinave.....	21
Neni 34 : Pozicionimi, Shpërndarja, Vendosja dhe Densiteti i Kontejnerëve Komunal.....	22
Neni 35 : Kontejnerët e Mbeturinave për Shërbim të Amvisërive në sistemin Shtëpi-për-Shtëpi.....	23
Neni 36 : Orari dhe Shpeshësia e Grumbullimit të Mbeturinave.....	24
Neni 37: Pastërtia e Lokacionit të Kontejnerëve dhe Ripozicionimi i Kontejnerëve .....	25
Neni 38: Transferimi i Ngarkesave të Mbeturinave të Ngurta Komunale nëpër Rrugët Publike.....	25
Neni 39: Ngarkesat e Pasigurta me Copëza të Mbeturinave dhe Rrjedhjet ....	25
Neni 40: Sjellja e të Punësuarve.....	25
Neni 41: Faturat për Ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave .....	26
Kapitulli 6 .....	26
Shërbimet Speciale për Grumbullimin e Mbeturinave .....	26
Neni 42: Shërbimet Speciale për Grumbullimin e Mbeturinave.....	26
Neni 43: Mbeturinat e Ngurta Komunale të Akumuluarra dhe të Pagrumbulluara .....	27
Kapitulli 7 Deponimi i Mbeturinave të Ngurta Komunale të Grumbulluara .....	27
Neni 44: Objekti i Licencuar për Deponim.....	27
Neni 45: Ndalimi i Djegies së Mbeturinave të Ngurta Komunale.....	28
Neni 46: Objekti Alternativ i Licencuar për Deponim.....	28
Kapitulli 8 Standardet Komerciale të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave .....	28
Neni 47: Faturat e Konsumatorit.....	28
Neni 48: Standardet e Shërbimit për Përgjigjet ndaj Konsumatorëve .....	28
Neni 49: Trajtimi i Ankesave dhe Pyetjeve të Konsumatorëve .....	29
<b>PJESA 6: SIGURIMI DHE GARANTIMI I PËRMBUSHJES.....</b>	<b>29</b>
Kapitulli 1 Sigurimi .....	29
Neni 50: Sigurimi.....	29
Neni 51: Dëshmia e Sigurimit.....	30
Neni 52: Shuarja ose Ndërprerja e Polisës së Sigurimit .....	30
Kapitulli 2 Garancioni i Përbushjes .....	30
Neni 53: Garancioni i Përbushjes.....	30
<b>PJESA 7: VËNIA NË JETË, DËNIMET DHE ANKESAT.....</b>	<b>31</b>
Kapitulli 1 Vënia në Jetë e Standardeve të Shërbimit.....	31
Neni 54: Vënia në Jetë e Standardeve të Shërbimit .....	31
Kapitulli 2 Shënime dhe Raportet mbi Standardet e Shërbimit.....	31
Neni 55: Mbajtja e Shënimeve.....	31
Neni 56: Raportet .....	31

Kapitulli 3 Kundërvajtjet, Dënimet dhe Gjobat .....	32
Neni 57: Kundërvajtjet, Dënimet dhe Gjobat .....	32
Kapitulli 4 Ankesat .....	32
Neni 58: Ankesat.....	32
<b>PJESA 8: TË NDRYSHME .....</b>	<b>33</b>
Neni 37 : Gjuhët.....	33
Neni 38 : Hyrja në Fuqi.....	33

## **PJESA 1: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Kapitulli 1 Fushëveprimi, Qëllimi dhe Definicionet**

#### Neni 1 : Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori nxjerr këtë Rregull nën autoritetin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit dhe Mbeturinave i datës 26 Nëntor 2004.

#### Neni 2 : Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj Rregulle është të përcaktojë dhe ti radhisë Standardet Minimale të Shërbimit të cilat Operuesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet t'i arrijë në ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe për mbajtjen e sistemeve të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të afta për të siguruar standardet minimale të kualitetit, sigurisë dhe besueshmërisë.

#### Neni 3 : Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është që të sigurojë se Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave ofrohen në një nivel minimal të pranueshëm të Standardeve të Shërbimit, të shërbimit, shëndetit, besueshmërisë

#### Neni 4 : Definicionet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregull do të përmbajnë kuptimet si në vijim:

**“Automjetet për Grumbullimin e Mbeturinave”** nënkupton automjetet e shfrytëzuara për Grumbullimin dhe/ose transportimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale;

**“Autoriteti Menaxhues”** nënkupton autoritetin dhe pushtetin e dhënë nën marrëveshjen me shkrim që lidhet në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe cilitdo Ofrues tjetër të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me të cilën në mënyrë të veçantë deklarohet se (1) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i dedikuar për atë qëllim në Konsolidim është i autorizuar dhe përgjegjës për mbikqyrjen menaxhuese dhe operuese të cilitdo Ofrues tjetër të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave e operon në Zonën e Shërbimit dhe (2) Ofruesi tjetër i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit do të jetë në pajtim me kërkesat e marrëveshjes në fjalë;

**“Banor”** nënkupton personin e gjallë që jeton brenda Zonës së Shërbimit;

**“Borxhet e Vjetra”** nënkupton të gjitha borxhet e Konsumatorëve lidhur me Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave që janë të evidentuara me Fatura të pakontestueshme të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave tek ai Konsumator me apo para 31 dhjetor 2002 dhe të cilat nuk janë paguar në tërësi siç është definuar dhe rregulluar në Rregullën e caktuar mbi Borxhet e Vjetra që lëshohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet nga Rregullatori kohë pas kohe;

**“Depoziti për Pajisje”** nënkupton shumën e të hollave të kërkuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nga Konsumatori si siguri financiare ndaj pasurive të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të vendosur në objektet e Konsumatorëve me qëllim të ofrimit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave;

**“Ditë Pune”** nënkupton cilado ditë përveç të shtunës dhe të dielës, festë e paraparë më ligj apo ditë tjetër që është Festë Zyrtare në Kosovë;

- “Fatura”** nënkupton dokumentin me shkrim që dërgohet tek Konsumatori me qëllim të caktuar për të ngarkuar Konsumatorët për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave të ofruara ose ndonjë entitet tjetër ligjor që ka të drejtë të bëjë një gjë të tillë dhe me një format dhe përmbajtje që ipet në këtë Rregull;
- “Festë Zyrtare”** nënkupton cilëndo ditë që njihet ose e dedikuar nga autoritetet qeveritare si ditë që nuk punohet;
- “Force Majeure”** nënkupton cilëndo ngjarje përtej kontrollit të pranueshëm i cili rezulton në parandalimin, ose vonimin e mbarëvajtjes së obligimeve të tij të përcaktuara nën këtë Rregull. Kjo përfshinë, por nuk është e kufizuar në zjarret, vërshimet, stuhitë, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimën, epidemitë, luftën, trazirat dhe rrëmuajt civile, sabotazhin dhe veprimet sanksionuese qeveritare;
- “Karta e Konsumatorëve”** nënkupton dokumentin e shkruar që është pregaditur nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe që i është vënë në dije secilit Konsumator dhe i cili rradhinë të drejtat dhe obligimet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të Konsumatorëve që kanë ndaj njëri tjetrit.
- “Komision Shqyrtues”** nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori konform Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;
- “Komisioni Këshillues i Konsumatorëve”** nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori konform Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;
- “Komuna”** nënkupton Komunitet lokal të paraqitura në Planin A në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/43 të 27 korrikut 2000 Mbi Numrin, Emrat dhe Kufijtë e Komunave në datën kur kjo Urdhëresë Administrative ka hy në fuqi
- “Konsumator Shtëpiak”** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;
- “Konsumator Institucional”** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Mbi Regjistrimin e Organizatave Afariste në Kosovë.
- “Konsumator Komercial-Industrial”** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumator i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
- “Konsumator”** nënkupton një person, që ka hyrë në Kontratë Shërbimi me një Ofrues të Shërbimeve ose ka marrë shërbime të ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve;
- “Kontejneri për Mbeturina”** nënkupton cilindo lloj të kontejnerëve ose shportat për mbajtjen e Mbeturinave të Ngurta Komunale të grumbulluara para mbledhjes dhe/ose heqjes së tyre;
- “Kontratë e Shërbimit”** nënkupton marrëveshjen me shkrim në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe Konsumatorëve të tij që i referohet Nenit 15 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;

- “Letër Jo-Kundërshtuese”** nënkupton letrën e lëshuar nga Rregullatori që deklaron jo kundërshtim për cilatdo veprime të cilave iu përgjigjet, megjithatë nuk bart vërtetim ose aprovim;
- “Licenca e Shërbimit”** nënkupton Licencën e lëshuar nga Rregullatori konform Rregullës së lëshuar nga Rregullatori, që autorizon Ndërmarrjet në Pronësi Publike ose Private të ofrojnë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave për publikun;
- “Marrëveshja për Pagesa të Shtyera”** nënkupton marrëveshjen në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe Konsumatorit lidhur me pagesën e Faturave me borxhe të vjetra përgjatë periudhës kohore që nuk do të tejkalojë dymbëdhjetë (12) muaj;
- “Marrëveshja për Pagesë”** nënkupton marrëveshjen në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të Konsumatorëve me qëllim të pagesës së Borxheve të Vjetra dhe siç është e definuar dhe e rregulluar në Rregullën e caktuar mbi Borxhet e Vjetra që lëshohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet nga Rregullatori kohë pas kohe;
- “Mbeturina Mjekësore”** nënkupton çdo mbeturinë që ka origjinë nga një vend apo aktivitet ku ipet përkujdesi mjekësor dhe përfshinë mbeturinat e produkteve infektive, anatomike, të mprehta, kimike dhe farmaceutike. Të gjitha Mbeturinat që kanë origjinën nga një vend apo aktivitet i tillë i përkujdesit mjekësor që nuk përmban Mbeturina të rrezikshme të paraqitura në këtë definicion, do të njihen si Mbeturina të ngurta komerciale;
- “Mbeturina të Ngurta Komunale”** nënkupton Mbeturinat e ngurta jo të rrezikshme të prodhuara nga amvisëritë, burimet komerciale dhe afariste, institucionale dhe Mbeturinat e procesuara industriale që nuk janë të rrezikshme;
- “Mbeturina Toksike”** nënkupton një produkt hedhurinë që mund të shkaktojë lëndime nëse thithet, gëlltitet apo absorbohet përmes lëkurës;
- “Mbeturina të Rrezikshme”** nënkupton produkte anësore të shoqërisë që mund të paraqesin rrezik të dukshëm ose rrezik të mundshëm për shëndetin njerëzor ose mjedisin kur ato menaxhohen në mënyrë të gabueshme. Substancat e klasifikuara si Mbeturina të Rrezikshme posedojnë së paku njërin prej katër karakteristikave në vazhdim: ndezshmërinë, korrozionin, reaktivitetin apo helmueshërinë ose janë klasifikuar si të Rrezikshme nga Bashkimit Evropian;
- “Mbeturina të Lëngëta”** nënkupton cilatdo Mbeturina në formë të lëngët duke përfshirë ujërat e zeza dhe llumin e kanalizimit;
- “Mbeturina Masive”** nënkupton artikujt e mëdhenj të Mbeturinave të Ngurta Komunale, duke përfshirë por jo e kufizuar në paisjet elektrike shtëpiake, mobiliet, trungjet e drunjve dhe copat e drunjve, beton dhe mbeturinat e rrënojave, gomat, dyert, dhe Mbeturina tjera të ngurta me përmasa të mëdha të cilat nuk mund të trajtohen në mënyrë të zakonshme nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën operative të Shërbimit;
- “Objekti i Licensuar për Deponim”** nënkupton objektin i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe ku entiteti operues i objektit është i licensuar nga Rregullatori për të operuar në atë objekt;
- “Ofrues i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave”** nënkupton secilin Person që ofron apo ka për qëllim të ofrojë Shërbim të Grumbullimit të Mbeturinave;

- “Orari për Grumbullimin e Mbeturinave”** nënkupton orarin e vendosur nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me të cilin janë caktuar zona, data, koha dhe shpeshësia e shërbimit.
- “Palë e Interesuar”** nënkupton Personin, Konsumatorin, Ofruesin e Shërbimeve, ose agjencinë qeveritare që kanë interes në shërbimet e ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave;
- “Parapagimi i Detyrueshëm”** nënkupton shumën e të hollave që Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i kërkon nga Konsumatori për arsye të posaçme që aplikohen ndaj pagesave për Faturat e ardhshme të ngarkuara në Konsumatorin në lidhje me Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave;
- “Person i Cenueshëm”** nënkupton cilindo Konsumator të klasifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si i varfër dhe skamnor;
- “Plani i Konsolidimit”** nënkupton planin e ristrukturimit të sektorit që është krijuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) për konsolidim dhe ristrukturim të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, dhe të Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave për Mbeldhjen e Mbeturinave të datës 10 shtator 2002 e ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar kohë pas kohe nga ana e Rregullatorit;
- “Peshorja”** nënkupton mekanizmin mekanik ose elektro-mekanik që është në gjendje të peshon automjetet me dhe pa ngarkesë në mënyrë që të përcaktojë peshën e ngarkesës. Disa lloje të caktuara të Peshoreve janë të pajisura me mekanizmin i cili ka aftësi për të regjistruar dhe të shtypë rastin e peshimit.
- “Regjistri i Konsumatorëve”** nënkupton regjistrin e krijuar, të ruajtur dhe të mbajtur nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe i cili përmban informacione prkatëse për Konsumatorin siç ipet në hollësi në këtë Rregull;
- “Rregullator”** nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Kosovë nën ligjin e aplikueshëm;
- “Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave Shtëpi-më-Shtëpi”** nënkupton shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave të Ngurta Komunale nga njësitë individuale me nga një familje ose Banesave;
- “Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave”** nënkupton Grumbullimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale dhe bartjen e tyre deri te Objekti i Licensuar për Deponim;
- “Standardet e Shërbimit”** nënkupton sa i përket Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave, standardet që aplikohen ndaj atij Shërbimi në përputhje me Rregullën e Standardeve të Shërbimit dhe nivelin minimal të standardeve që aplikohen ndaj atij shërbimi të përcaktuara nga Rregullatori në Kushtet e Licencës së Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave;
- “Tarifat e Shërbimit”** nënkupton çdo vlerë, çmim apo taksë të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në lidhje me dispozitat e shërbimeve të tij ndaj Konsumatorëve të vet;
- “Vendbanim”** nënkupton çdo shtëpi, banesë, vendbanim shumë-bloqesh, ndërtesë banimi, apo ndonjë hapsirë tjetër e përdorur për qëllime banimi;
- “Vendbanim”** nënkupton cilëndo vendndodhje për të cilin janë të kërkuar ose janë ofruar Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave;
- “Zona e Shërbimit”** nënkupton, në lidhje me Licensimin e Shërbimit, rajonin apo Komunën brenda së cilës Ofruesi përkatës i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të ofrojë shërbimet e veta;



**“Zonë e Pasigurt”** nënkupton zonën, vendin ose vendndodhjen, e cila konsiderohet e paarsyeshme ose e pasigurt ose e rrezikshme për punëtorët dhe/ose paisjet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për të pasur qasje me qëllim të ofrimit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

#### Neni 5 : Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, që nuk janë veçanërisht të definuara këtu dhe të cilat mund të jenë të paqarta, duhet të përmbajnë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të përmendura në Rregullore që autorizon këtë Rregull ose në cilindo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe
- (b) Referencat në Rregull duhet të interpretohen sipas kuptimit të cilësdo Rregulle të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me mandatin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas; dhe
- (d) Fjalët e cilësdo gjini që përdoren në këtë Rregull duhet të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Nenet, përveç nëse qëllimisht nuk caktohet ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nene të kësaj Rregulle.

### **PJESA 2: PARIMET E PËRGJITHSHME**

#### **Kapitulli 1 Aplikueshmëria**

##### Neni 6 : Aplikueshmëria

Të gjithë Ofruesit e Shërbimit të Mbeturinave në Kosovë janë të obliguar që t’i përmbahen kësaj Rregulle në mënyrën e cila do të përshkruhet nga Rregullatori kohë pas kohe.

#### **Kapitulli 2 Parimet e Përgjithshme për Standardet e Shërbimeve**

##### Neni 7 : Zbatimi i Përgjithshëm i Punës

- 7.1 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet gjatë gjithë kohës t’i përmbush obligimet e tija në mënyrë profesionale, të përpiktë, gjithëpërfshirëse, mjeshtërore, efektive dhe të sigurtë.
- 7.2 Banuesit përbrenda Zonës së Shërbimit kanë të drejtën që të pranojnë Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave sipas Standardeve të Shërbimit të përcaktuara me këtë Rregull duke siguruar se nga aspekti financiar dhe teknik është e mundur që Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave ta bëjë këtë.
- 7.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mos involvohet në grumbullimin, largimin dhe transportimin e materialeve të tjera të hudhura përpos Mbeturinave Komunale të Ngurta apo në ofrimin e shërbimeve tjera nga ato që në mënyrë specifike janë të radhitura në Licencën e Shërbimit të lëshuar nga Rregullatori.

##### Neni 8 : Standardet e Shërbimit Kuantitativisht të Definuar

- 8.1 Vlerat numerike specifike që janë tregues të Standardeve minimale të Shërbimit të përshkruara në këtë Rregull konsiderohen si kërkesa minimale dhe duhet të jetë obligim i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që t'ia ofrojë ato Konsumatorit.
- 8.1 Standrdet Minimale të Shërbimit siq jan të ofruara në këtë Rregull, nuk duhet të interpretohen sa I përket:
- (a) Reduktimit të Standardeve të Shërbimit ekzistuese nëse Shërbimi I Grumullimit të Mbeturinave me Standardet e Shërbimit më të vështira se Standardet e Shërbimit të vendosura me këtë Rregull; dhe
  - (b) Pengimit të cilitdo Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që të pajtohet t'i përmbushë Standardet e Shërbimit më strikte dhe më të vështira në cilatdo Marrëveshje të Shërbimit të lidhura me Komunën apo Kontratën e Shërbimit të lidhur me Konsumatorin.

Neni 9 : Ofrimi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

- 9.1 Të gjithë Konsumatorët kanë të drejtën të pranojnë Shërbimin e Grumbullimin të Mbeturinave nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duke siguruar se ofrimi i shërbimit është i mundshëm teknikisht dhe nga aspekti financiar.
- 9.2 Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave duhet tu ofrohen të gjithë Konsumatorëve Shtëpiak të cilët janë të vendosur përgjat rrugëve automobilistike, rrugëve dhe zonave në të cilat ka qasje për paisjet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nën kushtet normale të operimit.

Neni 10 : Obligimi për të Ofruar ose për të Mos Ofruar Shërbimet

- 10.1 Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave duhet tu ofrohen të gjithë Konsumatorëve te Amvisërive brenda Zonës së Shërbimit dhe të cilët gjenden përgjatë rrugëve publike, udhëve, rrugëve private dhe zonave të cilat janë të kalueshme për Automjetet për Grumbullimin e Mbeturinave të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nën kushtet normale të operimit dhe ku ofrimi i atyre shërbimeve është i mundshëm në mënyrë financiare dhe teknike.
- 10.2 Në rast se Konsumatori dështon të paguajë cilëndo shumë të paraqitur në Faturë siç kërkohet me kushtet e pagesës sipas marrëveshjes së arritur me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me të cilin është nënshkruar Kontrata e Shërbimit, Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave kanë mundësinë për të ofruar ose për të mos ofruar Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave vetëm nën kushtet si në vijim:
- (a) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të vazhdojë ofrimin e shërbimit për të gjithë Konsumatorët e Amvisërive të cilët marrin Faturat direkt prej Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në rast të pagesës së vonuar ose mos-pagesës së Faturave nga ana e Konsumatorëve të Amvisërisë. Në ato raste, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë mundësinë të kërkojë ndihmë nga autoritetet e caktuara dhe përkatëse për detyrimin dhe grumbullimin e atyre Faturave ose të lidhë Marrëveshje për Pagesa të Shtyera me Konsumatorin që nuk ka kryer pagesën.

- (b) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të vazhdojë ofrimin e shërbimeve për të gjithë Konsumatorët e Amvisërive të cilët marrin Faturat direkt prej Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të cilët janë kualifikuar si “ekonomikisht të pafavorizuar” nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në ato instanca Fatura duhet të përcjellët tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për t’u paguar.
- (c) Në interes të publikut, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave do të vazhdojë ofrimin e shërbimeve për spitalet, institucionet shëndetësore publike, institucionet religjioze, tregjet publike dhe stacionet e transportit publik. Konsumatorët e tillë mos-pagues do të raportohen tek Komunitatet ku ata janë të vendosur dhe sipas aplikueshmërisë tek ministrinë nën të cilat ata operojnë dhe të fundit duhet të jenë përgjegjës për pagesën e atyre Faturave.
- (d) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave do të ketë mundësinë për të vazhduar ose për të ndërprerë ofrimin e shërbimeve për Konsumatorët Komercial/Industrial të cilët marrin Faturat direkt prej Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në rast të pagesës së vonuar ose mos-pagesës së Faturës. Konsumatorët mos-pagues duhet të raportohen tek Komunitatet në të cilën ata gjenden dhe tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Nëse Fatura mbetet e papaguar për nëntëdhjetë (90) ditë ose më shumë, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë mundësinë që të lidhë Marrëveshjen për Pagesë të Shtyrë me Konsumatorin që nuk ka kryer pagesën dhe dështimi nga ana e Konsumatorit për të lidhë atë marrëveshje ose dështimi i Konsumatorit për të respektuar kushtet e paraqitura në Marrëveshjen për Pagesë të Shtyrë, do të rezultojë me atë që Konsumatori mos-pagues do të nënshtrohet dënimeve të lejuara nën ligjin e aplikueshëm dhe përpos kësaj atij do të vendoset ngarkesa nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për “hudhjen e ilegale të Mbeturinave të Ngurta Komunale”.
- (e) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave do të ketë mundësinë për të vazhduar ofrimin ose ndërprerjen e ofrimit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për Komunitatet që direkt marrin Faturat nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave që ofrohen në Zonën e Shërbimit pas periudhës prej nëntëdhjetë (90) ditëve pas afatit të maturuar të pagesës së Faturës. Në ato raste Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë të drejtë të përdorë të gjitha veprimet legale që janë në dispozicion për të marrur pagesën.

#### Neni 11 : Mos Diskriminimi

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të diskriminojë asnjë Konsumator, ose Konsumator potencial dhe të respektojë nivelet e njëjta të Standardeve të Shërbimit në tërë Zonën e Shërbimit pa marrë parasysh karakteristikat racore, etnike, kulturore ose ekonomike ose të standardit përkatës të jetesës së Konsumatorëve të cilët jetojnë në cilëndo pjesë të Zonës së Shërbimit.

## **PJESA 3: PROCEDURAT**

### **Kapitulli 1 Pajtueshmëria dhe Lirimi**

#### Neni 12 : Pajtueshmëria më Standardet e Shërbimit

Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të respektojnë Standardet e Shërbimit të përcaktuara me këtë Rregull përveç nëse në mënyrë të veçantë janë të liruar dhe të informuar me shkrim nga Rregullatori për të bërë një gjë të tillë.

#### Neni 13 : Lirimi nga Standardet e Shërbimit

- 13.1 Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të respektojnë Standardet e Shërbimit të vendosura nga Rregullatori përveç nëse Rregullatori aprovon kërkesën me shkrim që përkohësisht të lirojë aplikuesin-Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nga pajtueshmëria me cilatdo prej Standardeve të Shërbimit të përcaktuara në këtë Rregull.
- 13.2 Kërkesa me shkrim mbi lirimin që dorëzohet nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të theksojë qartazi Standardet e Shërbimit në fjalë, nivelin aktual të pajtueshmërisë, arsyet e pamundësisë të qenit në pajtim, afatet kohore të vlerësuar që kërkohen për të arritur pajtueshmërinë dhe, nëse është e aplikueshme, të propozojë tek Rregullatori nivelin e Standardeve të Shërbimit për të cilin pajtueshmëria do të mund të mbahej.
- 13.3 Rregullatori duhet të shqyrtojë kërkesën me shkrim mbi lirimin, e parashtruar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të përcaktojë nëse kufizimi kohor i liritimit nga pajtueshmëria e cilitdo Standard të Shërbimit duhet ti ofrohet Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, dhe/ose nëse Standardi i Shërbimit në fjalë duhet të modifikohet.
- 13.4 Rregullatori duhet të ofrojë vendimin e vet me shkrim për cilatdo kërkesa mbi lirimin nga pajtueshmëria me cilatdo Standarde të Shërbimit tek Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave brenda tridhjetë (30) Ditëve të Punës nga marrja e kërkesës me shkrim mbi lirimin nga pajtueshmëria të cilitdo Standard të Shërbimit në pajtim me nën-nenin 13.1 dhe nën-Nenin 13.2 të lartshënuar.
- 13.5 Cilido përjashtim i aprovuar nga Rregullatori për Standardet e Shërbimit me kërkesë të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, në pajtim me nën-Nenin 13.3 duhet të shqyrtohet çdo vit në datën e përvjetorit në të cilën është dhënë ai lirim ose ndonjë kohë tjetër që mund të vendoset nga Rregullatori për shqyrtim .
- 13.6 Cilado ripërtëritje ose zgjatje e liritimit nga pajtueshmëria dhe/ose cilatdo ndryshime në Standardet e Shërbimit të liruara, duhet ti komunikohen me shkrim Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave brenda tridhjetë (30) Ditëve të Punës nga data kur çështja është thirrur për shqyrtim nga Rregullatori.

### **Kapitulli 2 Rishikimi i Standardeve të Shërbimit**

#### Neni 14 : E Drejta e Rregullatorit për Rishikim, Ndryshim, Plotësim ose Zëvendësim të Standardeve të Shërbimit

Rregullatori do të ketë të drejtë të ndryshojë, plotësojë, modifikojë dhe/ose zëvendësojë cilindo Standard të Shërbimit të krijuar në këtë Rregull ose të shtojë cilatdo Standarde të Shërbimit plotësuese pas rishikimit të Standardeve të Shërbimit të krijuar me këtë Rregull për arsyt e bazuara në:

- (a) Korrigjimin e gabimeve të shtypit;
- (b) Adresimin e nevojave që kanë të bëjnë me faktorët gjeografik;
- (c) Adresimin e kushteve teknike të veçanta;
- (d) Adresimin e kushteve ekonomike të veçanta;
- (e) Adresimin e ankesave nga palët e interesit;
- (f) Ndryshimet në Ligje dhe Rregullore të Kosovës të cilat ndikojnë në Standardet e Shërbimit;
- (g) Adresimin e kërkesave për lirim nga Standardet e Shërbimit të parashtruara nga cilido ose të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

#### Neni 15 : Rishikimi i Standardeve të Shërbimit nga ana e Rregullatorit

- 15.1 Rregullatori duhet të rishikojë në bazë vjetore Standardet e Shërbimit të dhëna me këtë Rregull.
- 15.2 Rishikimi i Rregullatorit duhet të përfshijë komentet dhe raportet mbi respektimin të parashtruara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, komunikimet, ankesat dhe rekomandimet nga palët e interesit si dhe konkludimet nga cilatdo inspektime, vizita në terren, studime dhe anketa të përgatitura dhe/ose të hartuara nga Rregullatori që bëjnë evidentimin e rezultateve të fituara me zbatueshmërinë e Standardeve të Shërbimit.

#### Neni 16 : Njoftimi

- 16.1 Jo më vonë se në përvjetorin e datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, Rregullatori duhet të njoftojë me shkrim të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për ndryshimet, plotësimet, modifikimet, zëvendësimet dhe shtesat në cilatdo Standarde të Shërbimit, të cilat i ka aprovuar jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj para datës së përvjetorit.
- 16.2 Në rast se një Standard i vetëm ose kombinimi i Standardeve të Shërbimit janë rishikuar si rezultat i kërkesës nga cilido Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe ndonjë palë e interesit, rishikimi i kërkesës dhe vendimi i ofruar nga Rregullatori duhet të kompletohet dhe të i komunikohet me shkrim palës që ka bërë kërkesën brenda (30) Ditëve të Punës pas datës në të cilën është marrë kërkesa nga Rregullatori.
- 16.3. Dy (2) muaj para përvjetorit të datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle dhe të të cilitdo përvjetor pas kësaj, Rregullatori duhet të kontaktojë me Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për të i informuar ata për rishikimin dhe të kërkojë komentet e tyre mbi Standardet e Shërbimit aktuale dhe atyre të propozuara.
- 16.4. Kur të bëhen ndryshimet, plotësimet, modifikimet, zëvendësimet në Standardet e Shërbimit ose të jenë shtuar Standarde shtesë të Shërbimit, brenda tridhjetë (30) Ditëve të Punës nga aprovimi i atyre korrigjimeve, plotësimeve, modifikimeve,

zëvendësimeve dhe shtesave, Rregullatori duhet ti informojë me shkrim të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe duhet ti lejojë tridhjetë (30) Ditë të Punës që Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të bie në pajtim ose të dorëzojnë kërkesën për lirim tek Rregullatori.

#### **PJESA 4: MARRËVESHJA PËR STANDARDET E SHËRBIMIT**

##### **Kapitulli 1 Arsyet për Negociata dhe Lidhja e Marrëveshjes për Standardet e Shërbimit**

###### Neni 17 : Arsyet për të Lidhë Marrëveshjen për Standardet e Shërbimit

- 17.1 Rregullatori mund të lidhë marrëveshjen me shkrim me cilindo Ofrues të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me qëllim të ndryshimit zëvendësimit dhe/ose plotësimit të çfarëdo Kushti të Standardeve të Shërbimit të krijuar nën këtë Rregull.
- 17.2 Marrëveshja për Standardet e Shërbimit mund të lidhet duke dhënë cilatdo kushte paraprake të përcaktuara nga Rregullatori dhe të propozuara tek Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, duke përfshirë, pa kufizime, lidhjen e marrëveshjeve tjera detyruese me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për:
- (a) Lëshimin, ripërtëritjen, zgjerimin, ndryshimin, zëvendësimin dhe plotësimin e Licencës për Shërbime;
  - (b) Krijimin, shqyrtimin dhe/ose modifikimin e Tarifave të Shërbimit;
  - (c) Zgjerimin e fushëveprimit territorial të Zonës së Shërbimit;
  - (d) Rritjen e numrit të Konsumatorëve që u ofrohen shërbimet;
  - (e) Vendosja, ndryshimi, zgjerimi, modifikimi dhe/ose plotësimi i cilësdo dispozitë në lidhje me Konsumatorin ashtu si është theksuar në Rregullën mbi Kartën e Konsumatorëve të lëshuar, korrigjuar, modifikuar dhe/ose shtuar nga Rregullatori kohë pas kohe dhe që mund të ndikojë në cilindo prej Standardeve të Shërbimit.
- 17.3 Standardet e Shërbimit që janë subjekt i Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimit në asnjë rast nuk duhet të jenë më pak strikte apo më të lehta se sa Standardet e Shërbimeve të vëna nën këtë Rregull ashtu siç korrigjohen dhe/apo shtohen nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 17.4 Për mënjanim të dyshimit, Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave kanë të drejtë por nuk janë të obliguar që ti propozojnë Rregullatorit që të lidhin Marrëveshjen për Standarde të Shërbimit në pajtim me dispozitat e Nenit 18 të poshtëshënuar.

###### Neni 18 : Negocimi i një Marrëveshjeje për Standardet e Shërbimit

- 18.1 Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që dëshirojnë të lidhin Marrëveshjen për Standardet e Shërbimit duhet të dorëzojnë tek Rregullatori kërkesën me shkrim duke kërkuar hapjen e negociatave për të lidhë një marrëveshje të tillë duke dhënë arsyet se pse ata mendojnë që interesi publik edhe e drejta e tyre legjitime dhe pritjet ligjore do të shërbeheshin më së miri nëse Rregullatori do të pranonte të lidhë Marrëveshjen për Standardet e Shërbimeve.

- 18.2 Rregullatori duhet të përgjigjet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve të Punës që nga data e marrjes së komunikimit që referohet në nën-Nenin 18.1 më lartë, qoftë nëse pajtohet të hyjë në negociata për Marrëveshjen për Standarde të Shërbimit ose që refuzon të bëjë një gjë të tillë.
- 18.3 Nëse Rregullatori vendos të refuzojë t'i fillojë negociatat për lidhjen e Marrëveshjes për Standardet e Shërbimit, duhet të paraqes arsyet e veta për një refuzim të tillë.
- 18.4 Nëse Rregullatori pajtohet që të fillojë negociatat për lidhjen e Marrëveshjes për Standardet e Shërbimit, gjithashtu duhet t'i jep Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave një kohë të arsyeshme, në çdo rast jo më pak se tridhjetë (30) Ditë të Punës, që t'i lejojë Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të dorëzoj tek Rregullatori një Projekt të Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimeve.
- 18.5 Brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës që nga marrja e Projekt Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimit, Rregullatori duhet të njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për planifikimin e takimit të parë për të filluar negociatat për atë marrëveshje.
- 18.6 Rregullatori gjithashtu mund të përcaktojë një periudhë maksimale kohore për përfundimin e negociatave për të hyrë në Marrëveshjen e Standardeve të Shërbimeve që nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) Ditë Pune që nga data e takimit të parë negociues të aranzhuar si në nën-Nenin 18.5 të lartshënuar.
- 18.7 Për mënjanim të dyshimit, Rregullatori ka të drejtë por jo obligim që të lidhë Marrëveshjen për Standardet e Shërbimit prandaj si refuzimi i tij për të hyrë në negociata për të lidhë një marrëveshje të tillë ashtu dhe dështimi që me sukses të përfundohen negociatat e përmendura konsiderohen si vendime kontraktuese dhe jo si akte administrative apo vendime që i nënshtrohen ndonjë shqyrtimi administrativ dhe/ose juridik.

#### Neni 19 : Lidhja e Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimit

- 19.1 Në rast të përfundimit të suksesshëm të negociatave të drejtuara në pajtim me Nenin 18 të lartshënuar, Rregullatori dhe Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të lidhin me shkrim Marrëveshjen e Standardeve për Shërbime.
- 19.2 Marrëveshja e Standardeve të Shërbimeve do të nënshkruhet në tri versione në secilën nga gjuhët zyrtare që përdoret në Kosovë:
- (a) Shqip;
  - (b) Serbisht;
  - (c) Anglisht.
- 19.3 Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të ndonjë nga versionet në të cilat është nënshkruar Marrëveshja e Standardeve të Shërbimeve versioni anglisht duhet të mbizotërojë.
- 19.4 Përveç në rast se ndonjë fakt, informatë dhe/ose dokument mund të konsiderohet se përmban ndonjë informate të privilegjuar apo konfidenciale që Rregullatori mund ta justifikoj me vendim të shkruar, Marrëveshja për Standardet e Shërbimit, Shtesat e saja dhe të gjitha informatat e përdorura për negociata dhe për të lidhë

një marrëveshje të tillë duhet të publikohen apo të bëhen publike me mjetet të cilat Rregullatori mund t'i caktojë kohë pas kohe dhe që janë në dispozicion çdo herë për konsultim publik.

- 19.5 Cilatdo korrigjime, ndryshime, modifikime ose dispozita plotësuese që i përkasin Marrëveshjeve për Standardet e Shërbimeve duhet të kërkojnë pëlqimin e Rregullatorit dhe nënshkruesit të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave si dhe duhen të lidhen me shkrim, të botohen dhe të bëhen publike sipas dispozitave të nën-nenit 19.4 të lartshënuar.

## **Kapitulli 2 Natyra Ligjore dhe Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimit**

### Neni 20 : Natyra Ligjore

- 20.1 Marrëveshja e Standardeve të Shërbimeve konsiderohet si një kontratë administrative për të gjitha qëllimet e synuara ligjore duke qenë obligim i Rregullatorit që të negociojë, të lidhë dhe të ekzekutojë një marrëveshje të tillë me zbatim strikt të dispozitave të përgjithshme ligjore, rregullave dhe procedurave që qeverisin ushtrimin e prerogativave dhe detyrave të autoritetit publik
- 20.2 Marrëveshja e Standardeve të Shërbimeve, si akt ligjor bilateral, është ligjërishit i detyrueshëm, i imponueshëm dhe i zbatueshëm në pajtim me kushtet e saj për të dyja palët dhe mund të ndryshohet, zgjerohet, modifikohet, rishikohet dhe të ndërpritet vetëm në frymën e dispozitave të veta dhe ligjit të zbatueshëm në Kosovë.

### Neni 21 : Pajtueshmëria me Marrëveshjen e Standardeve të Shërbimit

Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave janë të obliguar që të respektojnë dhe të përshtaten me Standardet e Shërbimeve të vendosura në Kushtet e Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimit të vendosura në kushtet e përgjithshme në këtë Rregull:

- (a) Përderisa negociatat për lidhjen e Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimit janë të pezulluara deri në datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- (b) Menjëherë pas përfundimit, anulimit, revokimit dhe/ose përfundimit të Marrëveshjes së Standardeve të Shërbimeve në lidhje me çfarëdo të drejta dhe obligime të përfshira në Marrëveshjen për Standardet e Shërbimeve nuk është arritur pajtimi që të vazhdojë së ekzistuari kur të ndërpritet të jetë në fuqi dhe efekt të plotë për çfarëdo arsye ligjore;
- (c) Në të gjitha aspektet ku Marrëveshja për Standardet e Shërbimeve nuk përcakton ndryshe dhe/ose në të gjitha aspektet ku në mënyrë specifike nuk parashihet në marrëveshje të tillë.

## **PJESA 5: STANDARDET E SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 1 Orari i Punës dhe Qasja e Konsumatorëve**

#### Neni 22 : Zyra e Punës dhe Orari i Punës

- 22.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjatë gjithë kohës duhet të mbajë një zyre të punës funksionale dhe të kompletuar me staf në secilën Komunë me të cilat drejtpërdrejt ka Marrëveshje për Shërbime duke përfshirë edhe ato



Komuna të cilave u ofrohen shërbimet nga cilido Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nën Autoritetin e tij Menaxhues.

- 22.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mbajë të hapur zyren e punës gjatë gjithë kohës sa zgjatë orari i punës.

Neni 23 : Identifikimi i Ofruesit të Shërbimeve

- 23.1 Numri dhe emri i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që është në dispozicion për pranimin e kontakteve nga Konsumatorët në pajtim me Nenin 22 më lartë duhet të jetë i ekspozuar në mënyrë të dukshme në të gjitha automjetet dhe Kontejnerët Komunal që janë nën kontrollin operativ të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 23.2 Të gjithë të punësuarit e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të cilët kanë prirje të vënë kontakt me publikun duhet pajisur me kartelë identifikuese të cilën duhet ta bartin në mënyrë të dukshme dhe më praktike e cila duhet të përmban informatat si në vijim:
- (a) Fotografinë (më të re se 12 muaj) të punësuarit; dhe
  - (b) Emrin e të Punësuarit; dhe
  - (c) Emrin e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave; dhe
  - (d) Numrin kryesor të telefonit të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave; dhe
  - (e) Funksionin ose titullin e punës së të punësuarit.

**Kapitulli 2 Nën-Kontraktuesit**

Neni 24 : Shfrytëzimi i Nën-Kontraktuesve

- 24.1 Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet ti lejohet të përdorë shërbimet e nën-kontraktuesve të kualifikuar të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për të siguruar dhe për të mirëmbajtur kualitetin e shërbimeve të ofruara, për të zëvendësuar paisjet të cilat nuk janë funksionale, të rrisë numrin e Banorëve të shërbyer brenda Komunës ose Zonës së Shërbimit dhe të plotësojnë ose të përmirësojnë Standardet e Shërbimit të vendosura nga Rregullatori nën këtë Rregull.
- 24.2 Nën-kontraktuesit duhet të ofrojnë shërbimet e kontraktuara kryesisht përmes përdorimit të pajisjeve përkatësisht makinerisë që janë në pronën e tyre dhe duhet të i ofrojnë Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave listën e pajisjeve dhe makinerisë kryesore të cilën do ta përdorë për të kryer punën e kontraktuar.
- 24.3 Nga nën-kontraktuesit duhet të kërkohet të kryejnë punën në nivel të barabartë me Standardet e Shërbimit të krijuar nga Rregullatori në këtë Rregull dhe në bazë të atyre të vendosura në Marrëveshjen për Shërbime.
- 24.4 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të informojë Rregullatorin se ai është duke përdorë shërbimet e nën-kontraktuesit dhe gjithashtu duhet të ofrojë emrin e kompanisë së nën-kontraktuesit dhe zonën gjeografike brenda së cilës do të përmbushen shërbimet.

- 24.5. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë plotësisht përgjegjës për mbikëqyrjen dhe të monitorimin e të gjitha punëve të bëra nga nën-kontraktuesi që punon nën administrimin e tij dhe veç kësaj duhet të mbahet plotësisht dhe drejtpërsëdrejti përgjegjës ndaj Rregullatorit për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e Standardeve të Shërbimit si në vijim të kësaj Rregulle dhe ndaj Komunës për përmbushjen e obligimeve të tij nën Marrëveshjen për Shërbime.

### **Kapitulli 3 Ndërprerja e Shërbimeve për Shkak të Force Majeure**

#### Neni 25 : Rrethanat e Përgjithshme të Force Majeure

- 25.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të konsiderohet si mospërmbushës i zotimeve të veta nëse nuk është në gjendje të ofrojë Standardet e Shërbimeve për shkak të cilatdo fenomeneve të Force Majeure, ndikimi i të cilave nuk mund të shmanget përkundër ushtrimit të kujdesit dhe maturisë.
- 25.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të lirohet nga ofrimi i shërbimeve në nivelin e kërkuar në këtë Rregull kur një mospërmbushje vjen si pasojë e rasteve ose rrethanave të cilat janë të parandalueshme, që mund të evitohen dhe/ose që mund të ndreqen brenda një afati kohor të arsyeshëm.
- 25.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave brenda tre (3) Ditëve të Punës pas fillimit të cilësdo ngjarjeje të Force Majeure, duhet të raportojë atë rast tek Rregullatori, duke përfshirë përshkrimin e atij fenomeni si dhe të propozojë masat korrektuese dhe afatin kohor për implementim.

#### Neni 26 : Faktorët Klimatik

- 26.1 Sa herë që kushtet klimatike, duke përfshirë borën, akullin dhe shiun pamundësojnë Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të ofrojë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave të kërkuara, ai duhet të rifillojë me vazhdimësinë e shërbimit në Ditën e ardhshme normale të Punës.
- 26.2 Nëse kushtet atmosferike të përcaktuara në nën-Nenin 26.1 do të mbretërojnë për një periudhë prej më pak se dy (2) javë, atëherë Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të vazhdojë me ndryshime në orarin e punës që është dhënë në nën-Nenin 31.2 (a), nën-Nenin 31.3 dhe nën-Nenin 31.4.
- 26.3 Nëse kohëzgjatja e kushteve atmosferike të përcaktuara në nën-Nenin 26.1 mbretëron për një periudhë më të gjatë se dy (2) javë, atëherë Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të vazhdojë veprimet siç është dhënë në nën-Nenin 31.2(b), nën-Nenin 31.3 dhe nën-Nenin 31.4.

#### Neni 27 : Mbyllja e Rrugëve për Kalim

- 27.1 Sa herë që mbyllja e rrugëve të kalimit, rrugëve dhe rrugicave ndalon Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për të ofruar Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave të kërkuara në kohë sipas Standardeve të Shërbimeve të vendosura nën këtë Rregull, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ofrojë shërbimet më së voni në ditën e njëjtë ose në ditën e ardhshme normale të Punës.
- 27.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të kërkojë ndihmë prej Komunës për të pastruar rrugët e bllokuara të kalimit, të njoftojë autoritetet zbatuese të trafikut dhe të largojë automjetet e parkuara pa vend.

#### Neni 28 : Zonat e Pasigurta

- 28.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të mbahet përgjegjës për ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në cilëndo zonë, e cila konsiderohet e paarsyeshme ose e pasigurt ose e rrezikshme për të punësuarit e vet dhe/ose paisjet, e definuar si Zonë të Pasigurta.
- 28.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave menjëherë duhet të raportojë të gjitha Zonat e Pasigurta tek Komuna me të cilën ka Marrëveshjen për Shërbime dhe të bashkëpunojë me Komunën për t'i siguruar ato zona për ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave sa më parë që është praktike.
- 28.3 Për mënjanimin e dyshimit, sigurimi i Zonave të Pasigurta për ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjithmonë duhet të konsiderohen si përgjegjësi e veçantë e Komunave me autoritet mbi ato zona dhe/ose autoriteteve tjera kompetente dhe jo të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

### **Kapitulli 4 Ndërprerjet e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për Shkaqe që janë brenda Kontrollit të Ofruesit të Shërbimeve**

#### Neni 29 : Të Përgjithshme

Nëse Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dështon të ofrojë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave sipas orarit brenda Ditës së Punës për cilatdo arsye brenda kontrollit të vet, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të caktojë qoftë një shërbim shtesë për Grumbullimin e Mbeturinave deri në fund të Ditës së ardhshme të Punës ose të zgjasë orarin e punës në ditën e ngjarjes në mënyrë që të korrigjojë situatën sa më parë që është e mundur.

#### Neni 30 : Automjetet për Grumbullimin e Mbeturinave Jashtë Përdorimit

- 30.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mbajë të orarin e publikuar të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave pavarësisht nëse një ose më shumë Automjete për Grumbullimin e Mbeturinave janë apo nuk janë jashtë përdorimit.
- 30.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë mundësinë të shfrytëzojë shërbimet e nën-kontraktuesve si në vijim të Nenit 24 ose të merr me qira paisjet dhe/ose Automjetet për Mbledhjen e Mbeturinave në mënyrë që t'i përmbahet orarit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave.

#### Neni 31 : Shqetësimet, Akcionet dhe Grevat e Punëtorëve

- 31.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë përgjegjës për menaxhimin e praktikave të punës së tij dhe marrëdhënieve me punëtorët në lidhje me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ashtu që të parandalojë dhe kur kjo nuk arrihet, që menjëherë të rregullojë pasojat e dala nga shqetësimet e punëtorëve, akcionet e punëtorëve dhe/ose grevat në funksion të ofrimit në mënyrë efektive dhe me kohë të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me Standardet e Shërbimeve të përcaktuara në këtë Rregull.

- 31.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë përgjegjës, përbrenda kufijve të kësaj Rregulle dhe cilatdo kërkesave shtesë të dhëna në Marrëveshjen për Shërbime, për të mbledhjen dhe për të largimin e të gjitha Mbeturinave të Ngurta Komunale që mund ose janë grumbulluar dhe kanë mbetur të pa-Grumbulluara si rezultat i shqetësimeve, akcioneve dhe grevave të punëtorëve.
- 31.3 Grumbullimi dhe largimi i Mbeturinave të Ngurta Komunale të grumbulluara si pasojë e situatave të referuara në nën-Nenin 31.1 më lartë duhet të kompletohet si në vijim:
- (a) Nëse kohëzgjatja e shqetësimeve, akcioneve ose grevave zgjatë për një periudhë prej ose më pak se dy (2) javëve, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të shtojë katër (4) orë pune për secilin ndërrim punues dhe duhet të mbajë të zgjatura këto ndërrime të punës deri në atë kohë që Mbeturinat e Ngurta Komunale të cilat janë grumbulluar si rezultat i shqetësimeve, akcioneve ose grevave janë mbledhur, larguar dhe dërguar në Objektivin e Licencuar për Deponim; dhe
  - (b) Nëse kohëzgjatja e shqetësimeve, akcioneve ose grevave zgjatë për një periudhë më shumë se dy (2) javë, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të shtojë një tjetër ndërrim të plotë të punës për secilën Ditë të Punës sipas orarit dhe duhet të mbajë këtë mënyrë të punës së zgjatur deri në atë kohë që Mbeturinat e Ngurta Komunale të cilat janë grumbulluar si rezultat i shqetësimeve, akcioneve ose grevave janë mbledhur, larguar dhe dërguar në Objektivin e Licencuar për Deponim.
- 31.4 Në të dy rastet e radhitura në nën-Nenin 31.2(a) dhe nën-Nenin 31.2(b), Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë mundësinë të ofrojë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave në cilëndo ditë, duke përfshirë cilëndo festë Zyrtare, deri në atë kohë që Mbeturinat e Ngurta Komunale të cilat janë grumbulluar si pasojë e shqetësimeve, akcioneve ose grevave janë mbledhur, larguar dhe dërguar në Objektivin e Licencuar për Deponim.
- 31.5 Gjatë periudhës kohore brenda së cilës Ofruesi i Shërbimeve mban mënyrën e zgjatur të punës të referuar në nën-Nenin 31.2 dhe nën-Nenin 31.3, orari i rregullt i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i miratuar në mes të Komunës dhe Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin dhe largimin e Mbeturinave të ngurta komunale duhet të jetë i pandryshuar dhe të vazhdohet.

## **Kapitulli 5 Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave**

### Neni 32 : Pajisjet për Grumbullimin e Mbeturinave

- 32.1. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me të gjitha kostot dhe shpenzimet e përballuara nga vetë ai, duhet të ofrojë punëtorët, kontejnerët, makinerinë, veglat e pajisjeve, ndërmarrjet, ndërtesat dhe Automjetet për Grumbullimin e Mbeturinave sipas nevojës për të ofruar Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit sipas Standardeve të Shërbimit.
- 32.2. Të gjitha pasuritë dhe resurset e alokuara për ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të referuara në nën-Nenin 32.1 më lartë duhet të të mirëmbahen dhe në gjendje të funksionimit gjatë gjithë kohës, nën shpenzimet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

- 32.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjithmonë duhet të ketë në dispozicion paisjet dhe makinerinë në gjendje të funksionimit dhe me sasi të mjaftueshme që të mundë të ofrojë Shërbimet e kërkuara për Grumbullimin e Mbeturinave në mënyrë efikase dhe të dobishme ashtu siq është e përshkruar në Licencën e Shërbimit dhe në Marrëveshjen për Shërbime dhe sipas Standardeve të Shërbimit të vendosura në këtë Rregull.
- 32.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, drejtpërsëdrejti ose nëpërmes të marrëveshjes me palën e tretë, duhet të ketë në dispozicion pajisje dhe makineri rezervë e cila mund të mobilizohet në shërbim aktiv në afatin prej jo më shumë se 4 orë pas avarisë së pajisjeve ose makinerive e cila mund të shkaktojë vonesë ose ndërprerje në ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në pajtim me Standardet e Shërbimit të përcaktuara nën këtë Rregull.
- 32.4 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë i autorizuar të merr me qira, të jep me qira ose të nën-kontrakttojë me Ofruesit tjerë të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave cilatdo pajisje dhe makineri për Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave të cilat janë të pashfrytëzuara ose pjesërisht të shfrytëzuara duke siguruar se nuk prodhohen ndikime negative në shërbimet e ofruara ndaj Konsumatorëve të vet përgjatë tërë Zonës së Shërbimit.

#### Neni 33 : Ekzaminimi i Mbeturinave

- 33.1. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë përgjegjës për ekzaminimin paraprak të Mbeturinave të Ngurta Komunale të Grumbulluara për përcaktimin e pranueshmërinë së tyre për grumbullim.
- 33.2. Ekzaminimi i Mbeturinave të Ngurta Komunale duhet të jetë vizuel në natyrë.
- 33.3. Kategoritë në vijim të produkteve të Mbeturinave të Ngurta Komunale të do të jenë të papranueshme për mbledhje gjatë orarit të rregullt të Grumbullimit së Mbeturinave të Ngurta Komunale:
- (a) Mbeturinat dhe automjetet e braktisura dhe makineritë tjera motorike të cilitdo lloj; dhe
  - (b) Paisjet elektrike shtëpiake të mëdha siç janë frigoriferët, furrat dhe orenditë në amvisëri; dhe
  - (c) Kafshët e ngordhura dhe kafshët e therrura ose pjesët e tyre që janë si rezultat i veprimtarive hulumtuese ose shkatërrimi i kafshëve të sëmura që kanë peshë që tejkalon 20 kilogram; dhe
  - (d) Mbeturinat industriale që janë si rezultat i punëve prodhuese ose punëve industriale; dhe
  - (e) Mbeturinat e Rrezikshme, Mbeturinat Toksike, Mbeturinat Mjekësore dhe Mbeturinat shpërthyes (eksplozive) dhe radio aktive, hi i nxehtë, dhe
  - (f) Përpunimi i llumit të ujërave të zeza dhe cisternat e Mbeturinave septike; dhe
  - (g) Cilatdo Mbeturina të Lëngëta.
- 33.4 Nëse nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave përcaktohet se Mbeturinat e Ngurta Komunale të vendosura në cilindo kontejner ose shportë ose në cilindo vend të identifikuar sipas planifikimit si pikë e Grumbullimit, janë të papranueshme, të paautorizuara ose paraqesin rrezik për punëtorët e vet, Ofruesi i

Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë të drejtën e refuzimit të grumbullimit dhe/ose largimit të atyre Mbeturinave të Ngurta Komunale

- 33.5 Në rastin e paraparë në nen-Nenin 34.4, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të njoftojë Konsumatorin ashtu që të mundësohen të bëhen aranzhime të posaçme që të ato Mbeturina të Ngurta Komunale të papranueshme të largohen në mënyrë të ligjshme në mënyrë të sigurt dhe të duhur dhe të transportohen në Objektin e Licencuar për Deponim ose në deponi të lejuar dhe të autorizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të manovruar, mënjanuar, procesuar ose të sistemuar ato Mbeturina të papranueshme të Ngurta Komunale.
- 33.6 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të mbahet përgjegjës për Grumbullimin e artikujve të Mbeturinave të Ngurta Komunale, të cilat kanë madhësi dhe përbërje të tillë që nuk mund të manovrohen në mënyrë të sigurtë dhe/ose në mënyrë efektive teknike, nga ana e punëtorëve dhe pajisjeve të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave. Në këto raste, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të bëjë një aranzhim të posaçëm me Komunën në lidhje me largimin dhe transportimin e atyre artikujve.
- 33.7 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i cili konstatohet se me dijeni ka grumbulloj artikuj të papranueshëm të Mbeturinave të Ngurta Komunale të paraqitura në këtë Nen duhet t'i nënshtrohet dënimeve të përshkruara nga Rregullatori.
- 33.8 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë vetë përgjegjës për trajtimet shtesë ose shpenzimet për veprimet riparuese që mund të pësohen nga Objekti i Licencuar për Deponim, të cilat rezultojnë nga dërgimi i Mbeturina të Ngurta Komunale të papranueshme të përshkruara në këtë Nen.
- 33.9 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të grumbullojë dhe/ose transportojë dhe/ose deponojë cilatdo Mbeturina të Ngurta Komunale që janë nxjerrë dhe prodhuar jashtë Kosovës dhe janë transportuar me rrugë detare dhe/ose transportuar në Kosovë me qëllim të deponimit, riciklimit, për rigjenerimit të energjisë ose për transformim.

Neni 34 : Pozicionimi, Shpërndarja, Vendosja dhe Densiteti i Kontejnerëve Komunal

- 34.1. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave do të favorizojë vendosjen e Kontejnerëve të vet Komunal për ofrimin e shërbimeve për Konsumatorët e Amvisërive të cilët kërkojnë të u ofrohen shërbimet në këtë mënyrë (përmes Kontejnerëve Komunal)
- 34.2. Vetëm atëherë kur Konsumatorëve të Amvisërive u janë ofruar në mënyrë të duhur Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave në nivelin e Standardeve të Shërbimit të vendosur në këtë Rregull, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë mundësinë të vendosë Kontejnerët Komunal në lokacionet për shërbimin e kategoritë tjera të Konsumatorëve.
- 34.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të vendosë Kontejnerët Komunal në atë mënyrë që prezenca e tyre nuk do t'a pengojë asnjëherë rrjedhën normale të trafikut të automjeteve, qarkullimin e këmbësorëve, parkimin e veturave në mënyrë të autorizuar, funksionimin e sigurtë dhe të

përshtatshëm të stacioneve të autobusëve dhe/ose ndonjë vend tjetër të pajisjeve të përbashkëta në hapësirën publike.

- 34.4 Në zonat urbane, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pozicionojë Kontejnerët Komunal në atë mënyrë që të gjithë Konsumatorët e Amvisërive të mos janë më larg se dyqind (200) metra prej cilitdo Kontejner Komunal të caktuar.
- 34.5 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të sigurojë dhe pozicionojë Kontejnerët Komunal në atë mënyrë që densiteti i kapacitetit volumetrik të Kontejnerëve Komunal të mos jetë më i vogël se një (1) metër kub për shërbimin e njëqindpesëdhjetë (150) banorëve në ditë.
- 34.6 Numri maksimal i Kontejnerëve Komunal që duhet të vendosen në cilindo vend të vetëm i cili do të shërbente cilindo grup të Konsumatorëve të Amvisërisë duhet të jetë si në vijim:
- (a) Për shërbimet e amvisërisë shtëpi-për-shtëpi, kontejnerët mund të jenë të një rangu të madhësisë prej 1 deri 900 litra. Kontejnerët Komunal nuk duhet të përdoren për këtë lloj të shërbimit.
  - (b) Numri maksimal i Kontejnerëve Komunal në rangun e madhësisë prej 1,000 deri 2.900 litra, të cilët mund të vendosen në cilindo lokacion të veçuar, ose vend nuk duhet të tejkalojë sasinë totale pesë (5).
  - (c) Numri maksimal i Kontejnerëve Komunal në rangun e madhësisë prej tri (3) deri në shtatë (7) metra kub, të cilët mund të vendosen në cilindo lokacion të veçuar ose vend nuk duhet të tejkalojë sasinë totale tre (3).
  - (d) Numri maksimal i Kontejnerëve Komunal në rangun e madhësisë prej tetë (8) deri në dhjetë (10) metra kub, të cilët mund të vendosen në cilindo lokacion të veçuar ose vend nuk duhet të tejkalojë sasinë totale dy (2) përveç tregjeve publike dhe objekteve për transport publik në të cilin rast sasia e lejueshme të madhësisë së njëjtë të Kontejnerëve Komunal për një lokacion mund të rritet 100%.
  - (e) Për Kontejnerët Komunal në rangun e madhësisë prej tetë (8.0) deri në dhjetë (10.0) metra, numri maksimal i kontejnerëve në cilindo lokacion të veçuar duhet të jetë dy (2) përveç tregjeve publike dhe objekteve për transport publik në të cilin rast sasia e lejueshme e madhësisë së njëjtë të Kontejnerëve Komunal për një lokacion mund të rritet për 100%.
  - (f) Për Kontejnerët Komunal në rangun e madhësisë prej njëmbëdhjetë (11) deri në njëzetepesë (25) metra kub, numri maksimal i kontejnerëve në cilindo lokacion të veçuar duhet të jetë dy (2) përveç tregjeve publike dhe objekteve për transport publik në të cilin rast sasia e lejueshme e madhësisë së njëjtë të Kontejnerëve Komunal për një lokacion mund të rritet për 100%.

Neni 35 : Kontejnerët e Mbeturinave për Shërbim të Amvisërive në sistemin Shtëpi-për-Shtëpi

- 35.1. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, për të gjithë Konsumatorët që u ofrohen shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave Shtëpi-për-Shtëpi duhet të vë në dispozicion për qëllime të veçanta dy (2) kontejnerë për mbeturina me vëllimin që nuk tejkalon njëqind (100) litra.

- 35.2. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë mundësinë e ofrimit të kontejnerëve, që referohen në nën-Nenin 36.1 më lartë, me një çmim korrekt shitës të tregut, ose me qira apo falas.

Neni 36 : Orari dhe Shpeshësia e Grumbullimit të Mbeturinave

- 36.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, Komunës me të cilën ka lidhë Marrëveshjen për Shërbime duhet të i ofrojë orarin për të gjitha linjat e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe vendndodhjet e Kontejnerëve Komunal si dhe atë informacion ta mbajë aktual çdo herë.
- 36.2 Sa herë që Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në çfarëdo mënyre e ndryshon Orarin e Grumbullimit të Mbeturinave, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të informojë me shkrim Komunën në ditën pas së cilës janë bërë ndryshimet.
- 36.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, në orarin e vet të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përshijë parametrat operativ si në vijim:
- (a) Asnjë Shërbim për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të kryhet në zonat e banuara në mes të orës 23:00 të cilësdo ditë në vijim dhe orës 06:00 të ditës së ardhshme përveç nëse në mënyrë të veçantë është e lejuar të bëhet me Marrëveshjen për Shërbime me Komunën;
  - (b) Nuk duhet të planifikohen Shërbimet të rregullta për Grumbullimin e Mbeturinave në ditën e diele ose në ditët e Festave Zyrtare.
- 36.4 Orari i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që përdoret nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ofrojë në lidhje me shërbimin e Kontejnerëve Komunal frekuencën e grumbullimit dhe largimit sa vijon:
- (a) Për Kontejnerët Komunal, Grumbullimi duhet të bëhet së paku dy herë në javë në intervale të rregullta për të gjithë Kontejnerët Komunal në rrjedhën e planifikuar të grumbullimit për një kohë të caktuar të ditës dhe për ditët tjera të njëjta të javës;
  - (b) Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ofrohen brenda plus (+) ose minus (-) një (1) orë të intervalit në të cilën është planifikuar shërbimi për t'u ofruar në cilindo lokacion të caktuar ku Konsumatorëve të Amvisërisë u ofrohen shërbimet; dhe
  - (c) Pavarësisht nga kërkesat e nën-Nenit 36.4(a) dhe nën-Nenit 36.4(b), shpeshësia e Grumbullimit për cilindo lokacion të dhënë duhet të rritet në nivelin që parandalon grumbullimin e mbeturinave në tokë për arsye të kapacitetit të pamjaftueshëm ose orarit të pamjaftueshëm për Grumbullimin dhe largimin e tyre.
  - (d) Nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të kërkohet të ndryshojë orarin e shpallur për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave ose të ndryshojë numrin e kontejnerëve në cilindo vend të caktuar në mënyrë që të plotësojë kushtet sezonale ose të adresojë variacionet në modelet e gjenerimit të Mbeturinave të Ngurta Komunale në cilindo vend të caktuar ose në cilindo orar brenda Zonës së Shërbimit. Në ato raste, Kontejnerët Komunal duhet të shërbehen ashtu sipas përshkrimit të këtij Neni.



- 36.5 Shpeshhtësia e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për shërbimet e Amvisërive Shtëpi-për-Shtëpi në minimum duhet të jenë një herë në javë dhe duhet të jenë në ditën e njëjtë të javës.

Neni 37: Pastërtia e Lokacionit të Kontejnerëve dhe Ripozicionimi i Kontejnerëve

- 37.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e duhur dhe pastërtinë e lokacioneve të Kontejnerëve Komunal dhe lokacioneve të Kontejnerëve Komunal të shërbimit Shtëpi-për-Shtëpi ashtu që secili lokacion gjithmonë duhet të jetë pa mbeturina.
- 37.2 Pas zbrazjes dhe Grumbullimit të kontejnerëve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të largojë nga platforma ose hapësira e dedikuar për kontejnerë të gjitha copërat dhe mbeturinat të cilat kanë rënë ose janë grumbulluar në atë shesh ose hapësirë.
- 37.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet t'i vendosë dhe ripozicionojë të gjithë kontejnerët në lokacionet e tyre përkatëse të caktuara në pozicione vertikale dhe të gatshme për shfrytëzim.

Neni 38: Transferimi i Ngarkesave të Mbeturinave të Ngurta Komunale nëpër Rrugët Publike

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të transferojë Mbeturinat e Ngurta Komunale prej një automjeti në tjetrin në cilëndo rrugë publike ose në hapësirat e rrugëve publike përveç nëse ai transfer është i nevojshëm për metodën e funksionimit e cila është aprovuar më parë nga Komuna brenda së cilës ofrohen Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave ose për shkak të prishjes mekanike ose dëmtimit të rastësishëm të Automjeteve për Grumbullimin e Mbeturinave.

Neni 39: Ngarkesat e Pasigurta me Copëza të Mbeturinave dhe Rrjedhjet

- 39.1 Çdo Automjet për Grumbullimin e Mbeturinave nën kontrollin ose Menaxhimin e Autoritetit të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë ngarkesat e veta të lidhura, të mbuluara ose të mbajtura në atë mënyrë që do të parandalojë cilëndo pjesë të ngarkesës të bie nga Automjeti për Grumbullimin e Mbeturinave përderisa është duke punuar dhe deri atëherë kur ngarkesa të shkarkohet në Objektin e Licencuar për Deponim.
- 39.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të ndotë ose shkaktojë rrjedhje në cilatdo objekte banimi, rrugë ose hapësira publike.
- 44.3 Në rast të shkapërderdhjes ose rrjedhjes ose nëse Mbeturinat e Ngurta Komunale janë shpërndarë në ajër, shkapërderdhë ose kanë rrjedhur, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pastrojë të gjitha ato materiale të Mbeturinave të Ngurta Komunale brenda dy orëve nga ndodhja e asaj ngjarje, pa shpenzime për Konsumatorit.

Neni 40: Sjellja e të Punësuarve

- 40.1. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave është përgjegjës që me shpenzimet të veta të sigurojë trajnime dhe mbikëqyrje të domosdoshme për të gjithë të punësuarit e vet, duke përfshirë edhe ata që janë nën Autoritetin Menaxhues të tij të nevojshëm për të siguruar ofrimin e Shërbimeve për

Grumbullimin e Mbeturinave në nivel të Standardeve të Shërbimit të përcaktuar në këtë Rregull.

- 40.2. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në veçanti duhet të sigurojë se të gjithë punëtorët e angazhuar në ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave janë të sjellshëm, të kujdesshëm, minimizojnë zhurmën, shmangin dëmtimet në prona, mbyllin dhe rivëjnë dryrin në portat dhe dyert të cilat ata i hapin, mbyllin kapakët e kontejnerëve në pronat private, minimizojnë të gjitha bezdisjet në rrjedhën e trafikut si dhe gjithmonë mbajnë anën e shtigjeve për këmbësorë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Neni 41: Faturat për Ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përgatitë dhe duhet të dërgojë Faturat tek të gjithë Konsumatorët një herë në muaj sipas Tarifave të Shërbimit të publikuara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të aprovuara nga Rregullatori kohë pas kohe.

## **Kapitulli 6**

### **Shërbimet Speciale për Grumbullimin e Mbeturinave**

Neni 42: Shërbimet Speciale për Grumbullimin e Mbeturinave

- 42.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të bashkëpunojë me Komunën për të ofruar Shërbime speciale për Grumbullimin e Mbeturinave për të ndihmuar mbarëvajtjen dhe pastërtinë e përgjithshme të Zonës së Shërbimit dhe të komunitetit në tërësi.
- 42.2 Përpjekjet bashkëpunuese me qëllim siç është prezantuar në nën-Nenin 43.1 duhet të përfshijnë pjesëmarrjen aktive të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në fushata speciale të pastrimit të fshatrave, vendbanimeve, parqeve publike, dhe institucioneve ligjore dhe edukative, tregjeve publike dhe të ngjarjeve më rëndësi.
- 42.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të merr pjesë në ngjarjet speciale për pastrim të referuara në nën-Nenin 43.2 në vlerën e një (1) dite në muaj. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përfshijë shpenzimet e veta operative që janë të lidhura drejtpërdrejt me ato ngjarje në llogaritjet e veta të Tarifave të Shërbimit.
- 42.4 Kur Konsumatori i Amvisërisë është i paaftë fizikisht për një kohë të gjatë që Mbeturinat e Ngurta Komunale të cilat i ka krijuar t'i dërgojë në lokacionin ose vendin e caktuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, dhe kur një pamundësi e tillë është verifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, mund të aranzhohet një lokacion tjetër në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave pa asnjë shpenzim të ngarkuar mbi Konsumatorin e Amvisërisë.
- 42.5 Kur Konsumatori i Amvisërisë i cili normalisht do të duhej kualifikuar për Shërbime të Grumbullimit të Mbeturinave Shtëpi-për-Shtëpi është i vendosur në vendin i cili është i pakalueshëm për pajisjet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, një lokacion tjetër i ndryshëm duhet të dakordohet në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e

Mbeturinave dhe i cili nuk duhet të krijojë ndonjë shpenzim shtesë për Konsumatorin e Amvisërisë.

- 42.6 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ofrojë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave për Mbeturinat me Shumicë sipas:
- (a) Shpeshhtësisë me të cilën Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave me Shumicë duhet të ofrohen e që duhet të jenë pjesë e Marrëveshjes për Shërbime në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe Komunës; dhe
  - (b) Njoftimi paraprak për shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave me Shumicë duhet të shpallet dhe publikohet në zonat e dedikuara së paku shtatë (7) Ditë të Punës para të zhvillimit të ngjarjes; dhe
  - (c) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave është përgjegjës që më përpara të bëjë aranzhime me Objektivin e Licencuar për Deponim për pranimin e Mbeturinave Masive të Grumbulluara.

Neni 43: Mbeturinat e Ngurta Komunale të Akumuluar dhe të Pagrumbulluara

- 43.1. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të informojë Komunën me të cilën ka Marrëveshje për Shërbime për cilatdo Mbeturina të Ngurta Komunale të akumuluar për të cilat nuk mundet të identifikohet gjeneruesi dhe/ose pronari.
- 43.2. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të bëjë aranzhime, nëse nuk janë dhënë në Marrëveshjen për Shërbime me Komunën për Grumbullimin dhe largimin e Mbeturinave të ngurta të akumuluar dhe duhet t'i transportojë ato në Objektivin e Licencuar për Deponim sipas Tarifave të Shërbimit të aprovuara nga Rregullatori.

**Kapitulli 7 Deponimi i Mbeturinave të Ngurta Komunale të Grumbulluara**

Neni 44: Objekti i Licencuar për Deponim

- 44.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të transportojë dhe/ose deponojë cilatdo Mbeturina të Ngurta Komunale të cilat i ka mbledhur në cilindo lokacion ose vend tjetër nga ai i Objektivit të Licencuar për Deponim.
- 44.2. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të marrë nga Objekti i Licencuar për Deponim dokumentin vërtetues për secilën ngarkesë të Mbeturinave të Ngurta Komunale të dërguara.
- 44.3 Dëshmia e dërgesës së Mbeturinave të Ngurta Komunale të deponuara në Objektivin e Licencuar për Deponim duhet të paraqitet në formë të tiketës së Peshores që së paku duhet të përmbajë informacionin në vijim:
- (a) Datën dhe kohën e dërgimit;
  - (b) Datën dhe kohën e dërgesës së ngarkesës kur Automjeti për Grumbullimin e Mbeturinave del prej Objektivit të Licencuar për Deponim;
  - (c) Emrin e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që bën dërgesën;
  - (d) Numrin identifikues të Automjetit për Grumbullimin e Mbeturinave që e bën dërgesën, duke përfshirë numrin e kodit të tij si dhe numrin e targave të tij;

- (e) Emrin e Komunës, fshatit dhe/ose vendbanimit nga të cilët janë mbledhur Mbeturinat e Ngurta Komunale;
- (f) Emrin e Konsumatorit, nëse zbatohet, nga i cili janë mbledhur Mbeturinat për Grumbullimin e Mbeturinave;
- (g) Pesha bruto e Automjetit për Grumbullimin e Mbeturinave dukë përfshirë ngarkesën;
- (h) Pesha e ambalazhit të Automjetit për Grumbullimin e Mbeturinave; dhe
- (i) Neto pesha e Mbeturinave të Ngurta Komunale të ngarkuara në Automjetin për Grumbullimin e Mbeturinave;
- (j) Emri dhe nënshkrimi i punëtorit të Peshores;
- (k) Lloji i Mbeturinave të Ngurta Komunale të hedhura; dhe
- (l) Tarifat e aplikueshme të Shërbimit të aplikuar në deponimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale të hedhura.

44.4 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ruajë dëshminë e dokumenteve të dërgesës bashkë me shënimet e veta afariste sipas dispozitave të Nenit 55.

Neni 45: Ndalimi i Djegies së Mbeturinave të Ngurta Komunale

- 45.1 Rreptësisht është e ndaluar që Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të bëjë djegien e Mbeturinave të Ngurta Komunale për çfarëdo arsye.
- 45.2 Shkelja e ndalesës për djegien e Mbeturinave të Ngurta Komunale të Grumbulluara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të konsiderohet si kundërvajtje serioze e ndëshkueshme me gjoba të vëna nga Rregullatori.

Neni 46: Objekti Alternativ i Licencuar për Deponim

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për arsyet si në vijim duhet të ketë mundësinë e shfrytëzimit të përkohshëm ose përherëshëm të një Objekti alternativ të Licencuar për Deponim me aprovimin paraprak nga Rregullatori:

- (a) Mbyllja e përkohshme ose e përherëshme e Objektit të Licencuar për Deponim të shfrytëzuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave; ose
- (b) Qasja në Objektivin e Licencuar për Deponim e shfrytëzuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave është e mbyllur përkohësisht ose përgjithmonë.

## **Kapitulli 8      Standardet Komerciale të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave**

Neni 47: Faturat e Konsumatorit

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të dërgojë Faturën për secilin Konsumator për një periudhë minimum të një (1) muaji kalendarik dhe maksimum të dy (2) muajve kalendarik.

Neni 48: Standardet e Shërbimit për Përgjigjet ndaj Konsumatorëve

- 48.1 Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mbajnë regjistrin e thirrjeve telefonike, porosive dhe hollësitë e komunikimit të përgjigjeve duke përfshirë:
- (a) Emrin e Personit që zhvillon kontaktin;
  - (b) Kohën dhe datën kur është zhvilluar kontakti;
  - (c) Veprimet e ndërmarra nga punëtori në lidhje me thirrjet e Konsumatorëve;
  - (d) Hollësitë e zbulimeve dhe rezultatet e veprimeve nëse veç ka pasur ndonjë;
  - (e) Kohën dhe datën në të cilën është dhënë përgjigje në lidhje me çështjen;
  - (f) Nevoja e identifikuar për veprime të mëpastajme, nëse veç ka ndonjë; dhe
  - (g) Data dhe koha në të cilën veprimet në të ardhmen duhet të ndërmerren.
- 48.2 Thirrjet telefonike të pranuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në numrin e telefonit kryesor të publikuar duhet të kthehen para përfundimit të Ditës së ardhshme të Punës.
- 48.3 Në mënyrë periodike Rregullatori duhet të auditojë aktivitetet në lidhje me përgjigjet ndaj Konsumatorëve si dhe duhet të vlerësojë efektshmërinë e përgjegjeve ndaj çështjeve, problemeve dhe ankesave të bëra nga Konsumatorët dhe duhet të gjej mesataren e kohës që marrin përgjigjet nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

#### Neni 49: Trajtimi i Ankesave dhe Pyetjeve të Konsumatorëve

- 49.1 Ndaj ankesave në lidhje me Faturat, dyshimeve, ndërrimit të adresës dhe pyetjeve tjera komerciale duhet të ipet përgjegjja me shkrim brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës, dhe ndaj Konsumatorëve të ipet përgjegjja, ose nëse kërkohet hetimi, një përgjegje domethënëse vepruese. Të gjitha dyshimet duhet të zgjidhen Brenda njëzet (20) Ditë të Punës.
- 49.2 Për ankesat teknike lidhur me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ipet përgjegjja brenda gjashtë (6) orëve.
- 49.3 Kur Konsumatori kërkon caktimin e ndonjë vizitë ose takimi me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, takimi duhet të caktohet brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës nga data në cilën është kërkuar të caktohet takimi.
- 49.4 Në rast se është i pamundur të konfirmimi i takimit në kohën kur Konsumatori bën kërkesën, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të telefonojë ose të komunikojë me Konsumatorin brenda një (1) Dite të Punës, dhe të sigurojë kohën dhe datën për atë takim.

## **PJESA 6: SIGURIMI DHE GARANTIMI I PËRMBUSHJES**

### **Kapitulli 1 Sigurimi**

#### Neni 50: Sigurimi

- 50.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjithmonë duhet të mbajë në fuqi dhe efekt të plotë sigurimin e përgjithshëm të hollësishëm të detyrimeve publike, i cili duhet të përfshijë mbulimin për:
- (a) Objektet dhe detyrimin për punë;

- (b) Detyrimin Kontraktues;
- (c) Dëmtimet nga Zjarri dhe Shpërthimet;
- (d) Lëndimet personale dhe vdekja;
- (e) Sigurimin e përgjegjësisë së automjeteve motorike; dhe
- (f) Sëmundjet, paaftësinë për punë dhe/ose vdekjen e të punësuarve të vet për shkak të rrezikut në punë.

50.2 Mbulimi i sigurimit duhet të përfshijë të gjithë personelin dhe të gjitha automjetet në pronësi, të dhëna apo të marrura më qira që shfrytëzohen nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe nën Autoritetin e tij Menaxhues, në përmbushjen e obligimeve të tij që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

#### Neni 51: Dëshmia e Sigurimit

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë në gjendje që të ofroj dëshminë e dokumentuar të mbulesës së sigurimit për pikat e radhitura në Nenin 50 në formë të certifikatës së sigurimit, duke përfshirë faqet e deklaratës së polisës që qartë identifikon kompaninë e sigurimit, datat efektive të sigurimit, kufijtë e përgjegjësisë dhe emrin e entitetit të siguruar.

#### Neni 52: Shuarja ose Ndërprerja e Polisës së Sigurimit

52.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ndërpresë menjëherë në tërësi ose pjesërisht ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave pas shuarjes ose ndërprerjes së mbulesës së sigurimit që kërkohet nën Nenin 50. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mbahet përgjegjës për të gjitha dëmet dhe shpenzimet ndaj Konsumatorëve që dalin si rezultat i kësaj ngjarjeje.

52.2 Komunitat brenda Zonës së Shërbimit duhet të informohen menjëherë me zhvillimin e kësaj ngjarjeje të përshkruar në nën-Nenin 53.1 dhe duhet të i'u ofrohet informacionin për masat korrektuese që do të ndërmerren për të rivendosur situatën në gjendjen normale.

## **Kapitulli 2      Garancioni i Përmbushjes**

#### Neni 53: Garancioni i Përmbushjes

53.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mbajë në veprim të plotë Garancionin e Përmbushjes, ose një instrument të barasvlershëm financiar në favorin e Komunitës me të cilën ka lidhur Marrëveshjen për Shërbime.

53.2 Vlera e Garancionit të Përmbushjes, i cili duhet të mbetet në fuqi për kohëzgjatjen e Marrëveshjes për Shërbime në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe Komunitës, duhet të jetë e barabartë me tridhjetë e tre përqind (33%) të hyrave bruto vjetore të pritura nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave si rezultat i ofrimit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit.

53.3 Në rast se Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dështon të përmbushë shërbimet e kërkuara dhe pas konstatimit të Rregullatorit se ka bërë

kundërvajtje, Komuna duhet të ketë mundësinë për kthim dhe kompensim nga Garancioni i Përbushjes.

- 53.4 Institucioni financiar që lëshon Garancionin e Përbushjes duhet të jetë i licencuar në mënyrë të rregullt nga BPK-ja (Banka e Pagesave të Kosovës) për të ofruar ato shërbime financiare në Kosovë.

## **PJESA 7: VËNIA NË JETË, DËNIMET DHE ANKESAT**

### **Kapitulli 1 Vënia në Jetë e Standardeve të Shërbimit**

#### Neni 54: Vënia në Jetë e Standardeve të Shërbimit

- 54.1 Rregullatori do të monitorojë respektimin e Standardeve të Shërbimit të vendosura në këtë Rregull dhe mund të ndërmerr veprime të zbatueshmërisë ose vendime të Tarifave të Shërbimit të bazuara në performancën e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 54.2 Rregullatori duhet të monitorojë respektimin e Standardeve të Shërbimit në bazë të shënimeve dhe raporteve të përgatitura dhe të mbajtura nga Ofruesi i Shërbimit, raportet e përgatitura nga inspektorët e Rregullatorit, studimeve dhe anketave dhe nga ankesat e pranuar nga Konsumatorët.

### **Kapitulli 2 Shënimet dhe Raportet mbi Standardet e Shërbimit**

#### Neni 55: Mbajtja e Shënimeve

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mbajë shënimet e veta afariste, financiare dhe të kontabilitetit në selinë afariste të tij në një ambient të sigurtë dhe të siguruar dhe duhet të jetë në dispozicion gjatë orarit të rregullt të punës.

#### Neni 56: Raportet

- 56.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përgatitë dhe të i ofrojë Rregullatorit raportet në formë, përmbytje mënyrë dhe brenda kufijve kohor të shkruar nga Rregullatori në Shtojcat e kësaj Rregulle.
- 56.2 Si pasuese e nën-Nenit 58.1, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përgatitë dhe duhet të i ofrojë Rregullatorit raportet si në vijim:
- (a) “Raporti Tremujor i Zbatueshmërisë”, të dorëzohet tek Rregullatori në ditën e pesëmbëdhjetë (15) pas përfundimit të muajve mars, qershor, shtator dhe dhjetor të cilitdo vit të dhënë, do të ofrojë informacionet e kërkuara në lidhje me respektimin e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me Standardet e Shërbimit gjatë tremujorshit të raportuar; dhe
  - (b) “Raporti i Përmbledhur Vjetor i Zbatueshmërisë”, të dorëzohet tek Rregullatori me pesëmbëdhjetë (15) shkurt të vitit, duhet të përmbledh rezultatet e zbatueshmërisë të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për vitin paraprak; dhe
  - (c) “Raporti Vjetor për Rregullatorin”, të dorëzohet tek Rregullatori me pesëmbëdhjetë (15) shkurt të vitit, duhet të ofrojë informacionet e kërkuara në lidhje me vitin paraprak; dhe

- (d) “Raporti Tremujor i Ankesave të Konsumatorëve dhe Raporti i Vendimeve”, duhet të dorëzohen tek Rregullatori në ditën e pesëmbëdhjetë (15) pas përfundimit të muajve mars, qershor, shtator dhe dhjetor të secilit vit të dhënë, duhet të ofrojnë informacionet e kërkuara në lidhje me ankesat e regjistruara të Konsumatorëve dhe statusin e zgjidhjes të secilës ankesë gjatë tremujorshit të raportuar; dhe
  - (e) “Raporti Përmbledhës Vjetor i Ankesave të Konsumatorëve dhe Raporti i Vendimeve”, të dorëzohen tek Rregullatori më pesëmbëdhjetë (15) shkurt të secilit vit, duhet të ofrojnë informacionin e kërkuar në lidhje me shënimet e përpiluara të ankesave të Konsumatorëve dhe gjendjen e zgjidhjes së secilës ankesë gjatë tremujorshit të raportuar; dhe
- 56.3 Kohëzgjatja për të cilën Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ruaj shënimet e referuara në nën-Nenin 52.1 sipas qëllimit të kërkesave të kësaj Rregulle do të jenë:
- (a) Pesë (5) vite për “Raportin Vjetor tek Rregullatori”;
  - (b) Dy (2) vite për “Raportin Tremujor të Zbatueshmërisë me Standardet e Shërbimit”;
  - (c) Tri (3) vite për “Raportin e Përmbledhur Vjetor të Pajftueshmërisë me Standardet e Shërbimit”;
  - (d) Dy (2) vite për “Raportin Tremujorë të Ankesave të Konsumatorëve dhe Vendimeve”;
  - (e) Tri (3) vite për “Raportin Përmbledhës Vjetor të Ankesave të Konsumatorëve dhe Raportin e Vendimeve”.

### **Kapitulli 3 Kundërvajtjet, Dënimet dhe Gjobat**

#### Neni 57: Kundërvajtjet, Dënimet dhe Gjobat

- 57.1 Dështimi i respektimit të cilitdo nga Standardet e Shërbimit të përcaktuar nën këtë Rregull do të përbëjë kundërvajtje e cila do ta nënshtrojë Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që nuk plotëson zotimet e veta ndaj dënimeve ose gjobave të vëna në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 e datës 26 Nëntor 2004, mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit dhe Mbeturinave.
- 57.2 Gjobat për shkeljen e cilitdo Standard të Shërbimit gjithashtu duhet të vihen në pajtim me procedurat e krijuara nën Rregullat mbi vënien e gjobave dhe me cilatdo Rregulla tjera procedurale të përcaktuara nga Rregullatori kohë pas kohe.

### **Kapitulli 4 Ankesat**

#### Neni 58: Ankesat

- 59.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të ankohet tek Komisioni Shqyrtues i themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 te datës 26 Nëntor 2004, mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit dhe Mbeturinave ndaj cilatdo vendime formale të ofruara nga Rregullatori lidhur me zbatueshmërinë e Standardeve të Shërbimit të krijuar nën këtë Rregull.
- 59.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjithashtu mund të ankohet në gjykatat e Kosovës që janë kompetente për çështjen, ndaj vendimit të



Komisionit të Shqyrtimeve të referuar në nën-Nenin 59.1 të zbatueshmërinë së Standardeve të Shërbimit të vendosur në këtë Rregull.

## **PJESA 8: TË NDRYSHME**

### Neni 37 : Gjuhët

- 60.1 Kjo Rregull lëshohet dhe publikohet në tri versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:
- (a) Anglisht
  - (b) Shqip
  - (c) Serbisht
- 60.2 Në rast të ndonjë mos përputhjeje në mes të versioneve në të cilat kjo Rregull është lëshuar, versioni në gjuhën Angleze duhet të merret si bazë.

### Neni 38 : Hyrja në Fuqi

- 61.1 Kjo Rregull duhet të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditëve kalendarike prej datës së nënshkrimit.
- 61.2 Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave do të kenë gjashtë (6) muaj që të pajtohen ose të aplikojnë për lirimin nga ose për cilin do ndryshim të cilatdo Standardeve të Shërbimeve të krijuara si pasuese e kësaj Rregulle.

**Paulino Brillhante Santos**  
Drejtör

**Afrim Lajci**  
Zëvendës Drejtör

**Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina**